

Ndryshime te bera ne “Kodin e procedures civile”

L I G J

Nr.8491, date 27.5.1999

PER DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR.8116, DATE 29.3.1996
“KODI I PROCEDURES CIVILE”

Ne mbeshtetje te neneve 81 dhe 83 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Ne ligjin 8116, date 29.3.1996 behen keto ndryshime:

Neni 1

Neni 325 ndryshohet si vijon:

“Padia, sipas nenit 324 te ketij Kodi, mund te ngrihet kur paditesi argumenton se akti administrativ eshte i paligjshem dhe se atij i cenohen interesat dhe te drejtat e tij ne menyre te drejtperdrejte ose terthorazi, individualisht ose ne menyre kolektive.

Padise, per gjykimin e nje akti administrativ, i bashkelidhet nje kopje e aktit administrativ qe kundershtohet dhe çdo dokument tjeter provues.

Kerkimi i shperblimit te demit te shkaktuar nga akti administrativ i kunderligjshem mund te kerkohet sipas rregullave te pergjithshme edhe me padi te veçante.”

Neni 2

Ne nenin 326 shtohet paragrafi me kete permbajtje:

“- urdhrat me karakter ushtarak, ne kohe paqeje ose lufte, qe lidhen me gatishmerine ose veprimet luftarake.”

Neni 3

Ne nenin 331 shtohen dy paragrafe me kete permbajtje:

“- detyrimin e organit perkates, per te nxjerre nje akt administrativ, ne perputhje me ligjin ose per marrjen e masave per rivendosjen e se drejtes se cenuar;

- sakesimin e te drejtave dhe detyrimeve ndermjet paditesit dhe organit administrativ ne marredhenien ne konflikt, ne baze te ligjit dhe ne interpretim te marreveshjes kur ka te tille.”

Neni 4

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2390, date 7.6.1999 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Rexhep Meidani